

QENDRA RINORE VENERINI

POLITIKAT DHE PROCEDURAT MBROJTESE

PERMBATJA

1.Hyrje	4
1. Informacion i përgjithshëm mbi Qendren Rinore Venerini	4
1.2 Fomat e abuzimit që qendra synon te parandaloje.....	5
1.3 Vlerat tona	6
2.Linjat kryesore te politikës	7
2.1 Synimi i politikës.....	7
2.2 Objektivat e politikës.....	7
2.3 Prioritetet e politikës.....	8
2.4 Përgjegjshëria për kujdestarinë e fëmijes.....	9
2.5 Referencat ligjore.....	9
3. Përkufizimet kryesore te politikës	11
3.1 Fëmijë.....	11
3.2 Të rinjëte.....	11
3.3 Staf/Vullnetarët.....	11
3.4 Familjet e besuara.....	11
3.5 Vizitor.....	11
3.6 Media sociale.....	11
3.7 Përkufizimi i dhunës.....	12
3.8 Format e dhunës.....	12
3.9 Llojet e dhunës.....	13
4. Masat për ruajtjen e sigurt	17
4.1 Masat parandaluese për mbrotjen e fëmijëve.....	17
4.2 Përdorimi i imazheve të fëmijëve për qëllime të lidhura me punën.....	18
4.3 Rekrutimi i sigurt i stafit.....	19
4.4 Kodi etikës.....	22
5. Linjat e procedurave të mbrotjes	24
5.1 Linja të përgjithshme	24

5.2 Vlerësimi i rriskut.....	25
5.3 Ngritja e një shqetësimi.....	25
5.4 Oficeri i mbrotjes, roli dhe përgjegjsite.....	26
5.5 Procedurat e mbrotjes.....	26
5.6 Menaxhimi i rasteve.....	27
5.7 Monitorimi dhe vlerësimi.....	30
5.8 Procedurat e ankimimit.....	31
6. Aneke	32
6.1 Procedurat e shtëpise “Rozalba”.....	32
6.2 Procedurat nderinstitucionale.....	35
6.3 Kontrata e vullnetarit.....	38
6.4 Skeda e observimit.....	39
6.5 Formular për përdorimin e imazheve fëmijes.....	42
7. Lista e Referencave	43

1 .HYRJE

1.1 Informacion i pergjithshëm per Qendren Rinore” Venerini”.

Qendra Rinore Venerini u krijua ne vitin 1999 kur në Shqipëri nuk kishte qendra argëtuese apo pika referimi për qëllime edukuese. Në një vend ne tranzicion pas rënies se komunizmit,ishte e rëndesishme qe njerezit bga 6-20 vjec te kishin linja te forta dhe te qarta edukimi per ti ndihmuar ata per te ndertuar identitetin e tyre.Si motrat Venerini,eksperte ne fushën e edukimit dhe informimit,me shumë vite eksperience ne shumë vende te botës,ne dëshironim te zgjidhnim Shqipërine si një vend per te filluar këte pue edukuese.Me keto objektiva qendra u ndertua dhe menjëhere u bë vend i rëndesishem ne fshatin Gjadër ku nuk kishte asgjë.Në fillim ne mirëpritim djemtë e fshatit brenda qendrës duke ofruar aktivitete te ndryshme kulturore,shpirtore ,argetuese dhe sportive.Qëllimi ynë ishte:edukoni per te cilituar.Ishte brenda kësaj kornize që doli nevoja per hapjen e një shtepie familjeje. Shtëpia – “Rozalba“ është një entitet ligjor ,institucion i krijuar brenda Qendres Rinore Venerini,e cila e zhvillon aktivitetin e saj prej 20 vjetesh.Kjo eksperience e gjate nder vite ka bashkrenduar punen e shume individeve duke sjelle përvoja dhe rezultate pozitive ne te gjithë komunitetin ,e tashme nëpermjet shtëpise Rozalba ne te gjithë Shqipërine. Qendra Rinore Venerini realizon aktivitete te ndryshme,me baze te rinjte,dhe ka si qëllim te ndryshoje realitetin dhe perditshmerine e tyre duke e pasuruar dhe duke i rritur si individ te pavarur. Aktivitete e realizuara janë te niveleve te ndryshme ,artistike ,sportive,kulturore dhe fetare. Ofrohen kurse te ndryshme si kursi i kitares ,kursi i pianos,kursi i gjuhëve te huaja anglisht dhe italisht,kurse te lëndeve me vështiresi me te madhe si matematika,si dhe angazhimin dhe pergaditjen e te rinjeve ne sporte te ndryshme si futboll ose volejball. Por aktivitete e saj nuk jane te kufizuara vetem tek te rinjte ,pasi angazhime dhe mundesi ka pasur dhe vazhdon te kete edhe per moshat e tjera si prsh,mundesia per te marre sherbim shëndetsor nga mjeke te huaja te cilët e kane vizituar këte qender dhe jane ofruar vullnetarsisht. Po ashtu qendra Rinore Venerini,ofron here pas here në raste festash vakte ushqimore per te gjithë komunitetin e zones, si dhe i ndihmon ne te perditshmen ata te cilët kane me shume nevoje.Qendra Rinore Venerini po ashtu realizon aktivitete te ndryshme formuese,pjese e te cilave jane edhe vajzat e shtëpise Rozalba ,te cilat ne disa raste pasi arrijne nje moshe te caktua arrijne ti drejtojne keto aktivitete duke bashkendare ekperienca dhe duke u pasuaruar ne kete aspekt. Gjate periudhes se veres ,qendra Rinore realizon kampe verore me objektive formuese dhe

argetuese ,ku femijet ndahen ne grupe sipas moshes dhe realizojne lojra dhe aktivitete te ndryshme. Ne veveteve Shtëpia Rozalba dhe Qendra Rinore jane si dy realitete por te lidhura ngushte me njëra tjetrën ne çdo aspekt te perditshem. Rozalba u frymezua dhe lindi si nevojë e ekperiencave te veshtira te viteve te tranzicionit ne Shqipëri, ku me se shumti u preken femrat. Pergjate viteve 90/2000 femra ne Shqipëri ka qene vazhdimisht e rrezikuar nga faktor te ndryshëm, duke patur parasysh destabilitetin ne aspektin politik dhe social i cili solli si rrjedhoje edhe destabilitet ne aspektin familjar.Përgjate ketyre viteve,shumë vajza te reja u moren dhe u trafikuan jashte Shqipërise kryesisht. Ato binin pre e mashtrimeve te djemve dhe gjithçka niste si nje histori e bukur dashurie, e cila sillte keto pasoja. Ka patur dhe ka ende me qindra familje qe nuk e dine vendodhjen dhe fatin e ketyre vajzave te cilat u moren per qellime prostituimi apo dhe shitje organesh. Kjo frike lindi dhe u zhvillua edhe ne zonen ku Qendra Rinore Venerini realizonte aktivitein e saj ,kishte raste ku vajzat zhdukeshin pa lene gjurme. Por kjo qender ka luajtur nje rol te rendesishem ne formimin mbajtjen dhe formimin e shume te rejave duke i largaur nga shoqërite jo te mira dhe duke i nxitur në të dëshirën e një jete të bukur dhe dinjitoze. Ne keto kushte ,pasi kjo periudhe la gjurmët e veta ne familjet Shqipëtare,ku ndikuan me pas shume faktore si emigracioni,divorcet,dhuna,kushtet ekonomike te vështira etj ,shumë fëmije mbeten pa perkujdesje dhe disa prej tyre gjendeshin ne situata emergjente pa mbeshtetjen e askujt. Te nxitur nga deshira dhe nevojat e vendit ,u krijua qendra rezidenciale Rozalba,e cila ka mirepritur vajza nga gjithe Shiperia.**Rozalba** ka si qëllim të ndihmojë vajzat e mirëpritura , pra vajzat nga mosha 9-18 vjeçare, të rriten nga ana fizike, psikologjike dhe shpirtërore dhe ti ndihmojë ato në rritjen e një personaliteti dhe të një dinjiteti duke u nisur nga historia e tyre. Synohet që të bëhet e mundur rikuperimi i pikave te forta të historisë së tyre dhe zhvillimi i aftësive të tyre,për të pranuar dhe për të elaboruar atë që në historinë e tyre ka qenë dhe është jetuar si një traumë.Qendra kërkon t’u ofrojë mundësinë vajzave për të zbuluar që secila prej tyre është person unik, i pa përsëritshëm dhe i lirë. Projekti edukativ është një instrument, për ti ndihmuar vajzat që të zhvillohen nëpërmjet kujdesjes për veten,respektin ndaj personave dhe ambientit që i mirëpret. Gjithashtu synohet që vajzat të ndërtojnë marrëdhënie sociale të shëndetshme me bashkëmoshataret e tyre, dhe më të rriturit dhe ato që bashkëndajnë të përditshmen me to.Ky zhvillim është i mundur nëpërmjet një procesi gradual i cili realizohet në etapa të ndryshme.

1.2 Format e abuzimit qe synojme te parandalojme

- **Kujdesi dhe mbrojtja**

Shtëpia Rozlba është e anagazhuar te siguroje mbrotje për te gjithë rezidentet e saj.Rreziqet potenciale vlerësohen rregullisht dhe nevojat e secilit rezident percaktohen duke mbajtur relacione te vazhdueshme.Stafi sigron mbrotjen e rezidenteve sipas procedurave nga ekspert

te ndryshëm. Qendra mban një kopje te procedurave te mbrotjes dhe nje guide per praktikat ne mënyre që te shmangen fenomenet që mund ti lene vajzat te pambrojtura. Në këtë mënyre ato nuk preken nga sjellja negative e vajzave te tjera.

Qendra Rionore Venerini synon:

- a. Të respektoje dhe mbrojtë dinjitetin e rezidentëve te shtëpise “Rozalba”
- b. Të mbështese te drejtate njeriut per keto rezident
- c. Të ruaje privatsine e hsitorive te rezidentëve
- d. Mos te pranoje akte edukuese nese nuk janë miratuar nga drejtuesi i institucionit
- e. Ështe rreptësisht e ndaluar perdorimi i cfaredolloj dhune
- f. Të tregojme respekt per gjinine, politkat ,prejardhjen dhe kombesinë
- g. Të sigurojmë dhe te mbështesim lirine e mendimit
- h. Te garantojme edukimin per paqe dhe bashjetesë te shendetshme
- i. Të sigurojme programe te përshtatshme per zhvillimin fizik dhe mendor te rezidentëve te qendres,per një autonomi dhe vetëefikasitet per te ardhmen
- j. Të kryejmë detyrat sic duhet
- k. Të respektojmë dinjitetin dhe peronalitetin e rezidentëve
- l. Sigurimi i sherbimeve me perkushtim dhe profesionalizem
- m. Të jemi serioz dhe te aplikojme rregullat e etikës profesionale
- n. Të jemi te paanshëm ne mardhënie me rezidentet

Të parandalojme ,shmangim dhe te raportojme rastet e abuzimit(abuzimi fizik,abuzimi emcional,abuzimi seksual,abuzimi psikologjik,abuzimi financiar ose material,skllaverimi modern,abuzimi siskriminues,abuzimi insitucional,urrejtja dhe neglizhimi,bullizmi).

1.3 Vlerat tona

Qendra Rinore Venerini ka një numër vlerash që janë të rëndësishme për të pranuarit, si:

- **Dinjiteti dhe respekti:** Duke njohur vlerën e fëmijëve, veçantinë dhe të drejtën e tyre, personeli i Qendrës angazhohet që të trajtohen me dinjitet dhe respekt.
- **Barazia:** Sigurohet duke bërë kujdes që shërbimet në shtëpi të jenë të arritshme dhe të disponueshme për të gjithë. Shërbimi i ofruar nga kujdestaret nuk i gjykon të pranuarit në bazë të rrethanave, të kaluarës dhe mënyrën e jetesës së fëmijëve. Shërbimet garantojnë mosdiskriminim për shkak të racës,kulturës, gjuhës, besimeve fetare etj. Shërbimet mbështeten në individualitetin e klientëve, në perkushtimin, ndershmërinë dhe profesionalizmin e personelit.

- **Cilësia:** Duke nxitur shërbime cilësore që mbështeten në standardet e miratuara dhe përmbushin kërkesat ligjore dhe të praktikës më të mirë të arritur. Angazhimi për të siguruar që anëtarët e komunitetit do realizojnë objektivat në bazë të standardeve të miratuara.
- **Pavarësia:** Duke ju ofruar mundësi të pranuarve që të mendojnë dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur, duke ofruar sigurinë dhe intimitetin e tyre gjatë gjithë kohës.
- **Të drejtat:** Komuniteti angazhohet ndaj të pranuarve për të garantuar të drejtat dhe detyrimet e ligjshme, që parashtrihen në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.
- **Dëgjimi:** Angazhimi për të dëgjuar dhe ndihmuar që të shprehin dëshirat dhe nevojat e tyre në çfarëdo mënyre që i përshtatet më mirë të pranuarit të veçantë.
- **Zhvillimi dhe realizimi:** Inkurajohen për të realizuar potencialin e tyre të plotë, dhe ndihmohen të realizojnë shpresat dhe ambiciet e tyre për të zhvilluar aftësitë e tyre në jetën e përditshme.
- **Konfidencialiteti:** I gjithë informacioni personal i të pranuarit do të trajtohet në mirëbesim

2.LINJAT KRYESORE TE POLTIKËS

2.1 Synimi

Lindja dhe zhvillimi i institucioneve të tilla si Shtëpi Familjet dhe qendra Rinore janë risi për vendin tonë. Prandaj përgjate këtyre viteve, jemi përpjekur të bëjmë me të mirën për fëmijët, adoleshentët, të rinjtë dhe vajzat që kemi mirëpritur në qendër. Edhe Rozalba ka marrë tashmë formën e një institucioni që njihet dhe mbështetet në aktivitetin e saj të përditshëm, falë qëllimeve dhe objektivave të vendosura dhe të realizuara me sukses. Përgjate realizimit dhe rritjes së kapaciteteve tona dita ditës, lindin dhe zhvillohen shumë nevoja një prej të cilave është domosdoshmëria e të paturit të një politike që na udhëheq dhe orienton aktivitetin tonë si institucion tashmë i konsoliduar. Qëllim kryesor i kësaj politike është parandalimi i çfarëdo forme dhune brenda qendrës rinore. Ajo përfshin stafin, punonjësit vullnetarë, drejtuesit, familjet e besuara, vizitorët ose kontraktues të jashtëm për shërbime të ndryshme që kryhen apo shërbime të tjera që përfshin kontakte me fëmijët. Kjo politike i referohet të gjithë të rriturve që kanë kontakt me fëmijet përmes punës së tyre qoftë e paguar, vullnetare apo si vizitor. I referohet stafit të përhershëm dhe të përkohshëm, gjithashtu i referohet stafit që nuk ka përgjegjësi direkte për fëmijët por që do të ketë kontakt me fëmijët brenda qendrës dhe do të shihen si të sigurtë dhe të besueshëm dhe kanë akses në

informacione sensitive dhe konfidenciale. Kjo politike i referohet te gjithë vizitorve te qendres Venerini shqipëtar ose te huaj që marrin pjese ose janë prezent ose kanë kontakt me fëmijet dhe te rinjtë gjate qëndrimit te tyre. Ketu përfshihen sponsor ,donator,punonjës ndihmës ,vullnetar,staf i brendshëm ,konsulnet,përkthyes,apo njerëz te tjere per te cilët qendra planifikon udhëtime dhe projekte dhe me pas keta njerëz hyne ne kontakt me fëmijet dhe të rinjtë. Parimet e kësaj politike do te përfshihen ne kontrata dhe ne marreveshje per sherbimet e bera ndermjet qendres dhe kontraktoreve që sigurojne sherbime ose me stafin me te cilin punojnë.

2.2 Objektivat e politikës

Kjo politikë synon :


- Te realizohen procedurat dhe planet e mbrojtjes ne veprim per te mundësuar mbrotjen e pershtatshme per vajzat e qendres
- Te ndermerren hapa praktik dhe te arsyeshëm per te mbrojtur vajzat nga lendimi,diskriminimi dhe trajtimi degradues dhe te respektohen te drejtat ,deshirat dhe ndjenjat e tyre
- Të sigurohet qe te gjithë e kuptojne rolin dhe pergjegjsite ne lidhje me mbrotjen duke siguruar mundësi te pershtatshme te te mesuarit per te njohur,identifikuar dhe per tu pergjigjur shenjave te abuzimi,neglizhimit dhe shqetsimeve te tjera te mbrotjes ne lidhje me keto vajza
- Të sigurohet se kryhen vepime te pershtatshme ne rast incidentesh apo shqetesimesh abuzimi dhe sigurohet mbeshtjete e nevojshme per individët që ngrejne një shqetësim. Te gjitha shqetësimet per dyshime abuzimi duhen marrë seriozisht dhe tu jepete pergjigje ne mënyre te shpejte dhe te pershtatshme. Ështe pergjegjsia e gjithsecilit per te raportuar shqetesimet.
- Te sigurohet regjistrimi konfidencial i saktë dhe i detajuar i të gjitha shqetësimeve te mbrotjes,te cilat mbahen dhe ruhen ne vend te sigurt.

2.3 Prioritetet e politikës

- **Interesi më i Lartë i Fëmijës** - Të gjitha vendimet që do të merren duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës.
- **Konfidencialiteti** – I gjithë informacioni i ofruar do të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi. Duhet ndërmarrë masa për të mbrojtur privatësinë dhe identitetin e fëmijës; për më tepër të dhënat për çdo fëmijë duhet të mbahen e ruhen në një vend të sigurt.

- **Respektimi dhe promovimi i të drejtës së fëmijës për mbrojtje, përkujdesje dhe për t'u dëgjuar** – Çdo fëmijë do të trajtohet me respekt, dhe në përshtatje me zhvillimin e tij / saj individual, si dhe me nevojat dhe të drejtat për mbrojtje. Fëmija që është në gjendje të formojë pikëpamjet e tij/e saj, ka të drejtë t'i shprehë ato lirisht për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me të.
- **Mundësi ose trajtim i barabartë** - Të gjithë fëmijët do të marrin shërbime ose ndihmë në bazë të nevojave specifike që kanë, dhe nuk do të diskriminohen si rezultat i statusit që ata kanë, etnisë, prejardhjes, gjinisë, besimit fetar, moshës, vendndodhjes ose aftësisë.
- **Partneriteti dhe bashkëpunimi** – Mbrojtja e fëmijës dhe promovimi i mirëqenies së tyre është një përgjegjësi e përbashkët, dhe duhet të përfshijë të gjitha strukturat dhe shërbimet, fëmijët dhe familjen e tyre gjatë procesit të vendimmarrjes.
- **Sigurimi i pavarësisë, integrimi social dhe pjesëmarrjes në jetën komunitare** – Planet për fëmijët duhet të promovojnë aftësinë e familjes për t'u kujdesur në mënyrën e duhur, për të zhvilluar pavarësinë e tij/saj dhe për të inkurajuar integrimin social dhe pjesëmarrjen në komunitet.
- **Respektimi i përgjegjësive, të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.**

Dimensionet e Fëmijës



2.4 Përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve:

Përgjegjësitë për ruajtjen përcaktohen në legjislacion. Disa detyra zbatohen vetëm për fëmijët, disa aplikohen vetëm për të rriturit, dhe disa aplikohen për të dyja. Ekzistojnë dallime thelbësore mes kuadrit ligjor për ruajtjen e fëmijëve dhe atij për të rriturit, të cilat rrjedhin nga personat që mund të marrin vendime. Të rriturit kanë të drejtën ligjore për të marrë vendimet e tyre, edhe nëse nuk janë të mençur, për sa kohë që ata kanë aftësinë për ta marrë atë vendim dhe janë të lirë nga shtrëngimi ose ndikimi i papërshtatshëm. Megjithatë, pushteti vendimmarrës në lidhje me fëmijët qëndron tek ata që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën. Ndërsa fëmija rritet në pjekuri dhe botëkuptim, ligji i jep fëmijës një peshë më të madhe në vendimmarrje. Sapo fëmija arrin të kuptojë plotësisht zgjedhjen që duhet bërë dhe pasojat e saj, mendimi i fëmijës mbizotëron, të paktën për sa i përket miratimit, edhe pse me raste gjykatat janë të përgatitura të anashkalojnë refuzimin e një fëmije të aftë për trajtimin e shpëtimit të jetës. Kur është 18 vjeç, personi i ri është një i rritur. Kur çështja në lidhje me edukimin e një fëmije ose paratë apo pasurinë e tij/saj shqyrtohet nga një gjykatë, ligji e bën të qartë se "mirëqenia e fëmijës është konsiderata kryesore e gjykatës", e njohur gjerësisht si "**parimi i interesit më të lartë të fëmijës**", i cili ka një ndikim të gjerë në praktikën e kujdesit social ndaj fëmijëve, duke theksuar të gjitha ato element që një gjykatë duhet të marrë në shqyrtim në mënyrë që të arrij në përfundimet e duhura. Përfituesit, donatorët, të cilët punojnë me grupe vulnerabël, duke përfshirë fëmijët, duhet të veprojnë gjithmonë **në interesin e tyre më të lartë** dhe të sigurojnë që të ndërmerren të gjitha hapat e arsyeshme për të parandaluar dëmtimin e tyre. Pasja e garancive mbrojtëse brenda një qendre përkujdesi jo vetëm që mbron dhe promovon mirëqenien e fëmijëve, por gjithashtu rrit besimin e administratorëve, stafit, vullnetarëve, prindërve / kujdestarëve dhe publikut të gjerë.

2.5 Referencat ligjore

Institucioni rezidencial i përkujdeset për fëmijët 6-18 vjeç, funksionon në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara sipas politikave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore dhe udhëzimeve përkatëse.

- Ligji Nr.9355 dt 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore ”
- Ligji Nr 10347 dt 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”
- VKM Nr 659 dt 17.10.2005 “Për standardet e Shërbimeve të përkujdesit Shoqëror
- VKM Nr 659 dt 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale“
- VKM Nr.425 dt 27 06.2012 “Për kriteret e vendosjes ne institucione rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim”i ndryshuar
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve
- Ligji nr. 18/2017 "Për mbrojtjen e fëmijëve"
- Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 " Për mbrojtjen nga diskriminimi "
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale

3.PËRKUFIZIME KRYESORE TË POLITIKËS

3.1 Fëmije:

Një fëmijë ose një person i ri nënkupton dikë që është nën 18 vjeç, domethënë nuk ka arritur ditëlindjen e 18-të. Kjo mund t'i referohet fëmijës / personit të ri me të cilin punojmë drejtpërsëdrejti, ose fëmijës së njërit prej këtyre të rinjve, ose të një personi tjetër, me të cilin jemi në kontakt gjatë punës sonë.

3.2 Të rinj

I referohet të rinjve midis moshave 12 dhe 24 vjeç

3.3 Stafi ose Vullnetarët

I referohet çdo të rrituri i cili është i punësuar, porositur ose kontaktuar për të punuar me ose në emër të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në nevojë, me pagesë ose pa pagesë.

3.4 Familje të besuara

Qendra rinore vërejtë se ka një bashkëpunim të rëndësishëm me disa familje të komunitetit. Stafi i njëjtit keto familje shumë më mirë pasi ato janë pjesëmarrëse në aktivitete të qendres ose kanë qenë vullnetarë. Fëmijet e tyre kanë luajtur një rol të rëndësishëm në iniciativat tona për fëmijët dhe të rinjtë gjithashtu. Mardhënia e vajzave me këto familja është ndërtuar në mënyrë krejtësisht natyreshme. Kur vajzat dëshirojnë të qëndrojnë disa ditë tek njëra prej këtyre familjeve, ato e zgjedhin vetë se ku duan të shkojnë. Megjithatë keto familje kanë

bashkëpunuar prej vitesh me qendren anëtare të caktuar të stafit,realizojnë një vizitë paraprake.Stafi shikon me shume kujdes ambjentin familjar,kushtet e akomodimit dhe vendos nëse është një mjedis i përshtatshëm dhe i sigurt për vajzat.Gjithashtu familjet marrin informacion nga stafi për vajzat mbi,ushqimet e preferuara,orëret e studimit ,arëtimin apo nevojat e tjera të vecanta që mund të ketë fëmija.Ato marrin udhëzime mbi menaxhimin e rastve edhe procedurat e raportimit kur ngrihet një dyshim,dhe patjetër ata duhet të firmosin kodin e etikës ,në mënyrë që të sigurojnë shërbime dhe të bashkëpunojnë me qendrën.Keto familje duhet të firmosin një formular ,tek i cili pranojnë të marrin të gjitha përgjegjësitë gjatë qëndrimit të vajzave në shtëpitë e tyre.

3.5 Vizitor

I referohet një personi, duke përfshirë donatorët, me të drejtën ose detyrën që herë pas here të jetë i pranishëm për të inspektuar dhe raportuar për aktivitetet e Qendrës Rinore Venerini

3.6 Media Sociale

Mediat sociale i referohen metodave të rrjetit me bazë në internet duke përdorur mjete të bazuara në ëeb për të komunikuar gjerësisht, shpejt dhe me lehtësi me qëllim të shkëmbimit të informacionit (publik ose privat), kërkimit të informacionit dhe komunikimit me të tjerët. Shembuj të mediave sociale përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: email, instant messenger, Skype, Facebook, Tëitter, Instagram, YouTube, Vimeo, Tumblr, LinkedIn, EëhatsApp, podkaste, borde mesazhesh, eëiki, mesazhe tekstuale, botë virtuale, dhoma, dhe forume të tjera të diskutimit në grup në internet ose rrjetet sociale. Kjo përfshin çdo gjë të botuar në internet ose në një intranet.

3.7 Përkufizimi i Dhunës

Dhuna është përkufizuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si "përdorimi i qëllimshëm i forcës ose forcës fizike, të kërcënuar ose aktuale, kundër vetvetes, një personi tjetër, ose kundër një grupi ose komuniteti, ose që rezulton ose ka një gjasë të madhe për të shkaktuar lëndime, vdekje, dëm psikologjik, keqpërdorim ose privim. Ky përkufizim përfshin në mënyrë të qëllimshme kryerjen e vetë veprës, pavarësisht nga rezultati që prodhon. Megjithatë, në përgjithësi, çdo gjë që ngacmohet në një mënyrë të dëmshme ose dëmtuese mund të përshkruhet si e dhunshme edhe nëse nuk ka për qëllim të jetë e dhunshme (nga një person dhe kundër një personi)".

3.8 Format e Dhunës

Dhuna fizike - Dhuna fizike mund të marrë shumë forma, por mund të përfshijë: shpulla, goditje, mbytje, therje

Dhuna seksuale - Dhuna seksuale mund të ndodhë në kontekstin e partnerëve dhe familjes, në vendet e punës, në shkolla dhe në shumë rrethana të tjera. Ai përfshin:

- Ngacmimin seksual, p.sh. ngacmimet verbale në rrugë, fishkëllimat, vështrimi i tepërt, ndjekja e dikujt, duke bërë kërkesa të padëshiruara / të përsëritura për seks
- Ngacmimi seksual, duke dërguar imazhe pornografike të padëshiruara për të kërcënuar ose frikësuar dikë, duke e kërcënuar për të ndarë fotot lakuriq, duke bërë kërcënime për përdhunim.
- Puthjet e padëshiruara dhe prekja seksuale.
- Presioni seksual dhe detyrimi; p.sh. duke bërë kërcënime për t'u ndarë nëse dikush nuk merr pjesë në seks, duke luajtur lojëra mendjeje për të mashtruar dikë në akte seksuale të padëshiruara.
 - Sulmi seksual, duke përfshirë përdhunimin.
- Mitet e përdhunimit dhe fajësia e viktimave.

Dhuna emocionale ose psikologjike - sjellje kontrolluese si izolimi i dikujt nga miqtë, familja dhe kultura; duke bërë kërcënime për të kryer vetëvrasje ose vetë-lëndim; kërcënime për shkatërrimin e pasurisë; përçmimi ose poshtërimi i dikujt në publik ose privatësisht; thirrjen me emra dhe sulmimi i karakterit ose personalitetit; duke minimizuar arritjet, zhvlerësuar mendimin, ose duke marrë merita për sukses, për shembull duke thënë gjëra të tilla si "ti nuk do të ishe asgjë pa mua"; "Çfarë mendon ti nuk ka rëndësi"; ose "e ke marrë atë punë vetëm për shkakun tim." Duke bërë kërcënime për të publikuar foto lakuriqe ose për të ndarë detaje intime me njerëz të tjerë.

Dhuna ekonomike - kontrollimi i financave, marrja e vendimeve për mënyrën e shpenzimit të parave. Abuzimi ekonomik është një formë abuzimi kur një partner intim ka kontroll mbi aksesin e partnerit tjetër në burimet ekonomike, gjë që zvogëlon kapacitetin e viktimës për të mbrojtur veten dhe e detyron atë që të varet nga abuzuesi financiarisht. Ajo është e lidhur me, ose është gjithashtu i njohur si abuzimi financiar, i cili është përdorimi i paligjshëm ose i paautorizuar i pasurisë së një personi, i parave, i librezës së pensionit ose i sendeve të tjera me vlerë (duke përfshirë ndryshimin e vullnetit të personit për ta emëruar abuzuesin si trashëgimtar) e avokatit, pasuar nga privimi i parave apo pasurive të tjera, ose nga dëbimi nga shtëpia e vet. Abuzimi financiar aplikohet si për abuzimet e të moshuarve dhe dhunën në familje. Një dallim i rëndësishëm midis abuzimit ekonomik dhe abuzimit financiar është se

abuzimi ekonomik përfshin gjithashtu kontrollin e potencialit të ardhshëm ose të potencialin e ardhshëm të dikujt duke i penguar ata të marrin një punë ose arsimim.

3.9 Llojet e dhunës

Dhuna e vetëdrejtuar: Dhuna e drejtuar ndaj vetes ndahet në:

- **Sjellje vetëvrasëse**, e cila përfshin mendime vetëvrasëse, tentativë për vetëvrasje (e quajtur edhe para-vetëvrasje) ose vetë-dëmtim i qëllimshëm në disa vende dhe vetëvrasje të përfunduara.
- **Vetë-abuzimi**, e cila përfshin akte të tilla si vetë-gjymtimi.
- **Dhuna kolektive:** Dhuna kolektive ndahet në:
- **Dhuna strukturore:** Dhuna kolektive që është e përkushtuar për të avancuar një axhendë të veçantë sociale përfshin, për shembull, krimet e urrejtjes të kryera nga grupe të organizuara, akte terroriste.
- **Dhuna politike** përfshin luftën dhe konfliktet e dhunshme, dhunën e shtetit dhe akte të ngjashme të kryera nga grupe të mëdha.
- **Dhuna ekonomike** përfshin sulme nga grupe më të mëdha të motivuara nga përfitimet ekonomike, siç janë sulmet e kryera me qëllim të ndërprerjes së aktivitetit ekonomik, mohimi i aksesit ndaj shërbimeve thelbësore, ose krijimi i ndarjes ekonomike dhe fragmentimit. Është e qartë se veprimet e kryera nga grupet më të mëdha mund të kenë motive të shumta.

Nën-kategoritë e dhunës kolektive sugjerojnë motivet e mundshme për dhunën e kryer nga grupe të mëdha individësh ose shtete.

Lufta: Lufta është një gjendje e konfliktit të zgjatur të dhunshëm në shkallë të gjerë që përfshin dy ose më shumë grupe njerëzish, zakonisht nën patronazhin e qeverisë. Kjo është forma më ekstreme e dhunës kolektive.

Jo fizike: Dhuna nuk mund të rezultojë domosdoshmërisht në plagosje ose vdekje, por megjithatë përbën një barrë të konsiderueshme për individët, familjet, komunitetet dhe sistemet e kujdesit shëndetësor në mbarë botën. Për shembull, shumë forma të dhunës kundër grave, fëmijëve dhe të moshuarve mund të rezultojnë me probleme fizike, psikologjike dhe sociale që nuk sjellin domosdoshmërisht lëndime, paaftësi ose vdekje. Këto pasoja mund të

jenë të menjëhershme, si dhe të vonuara, dhe mund të zgjasin me vite pas abuzimit fillestar. Përcaktimi i rezultateve vetëm në aspektin e lëndimit ose vdekjes kufizon kështu kuptimin e ndikimit të plotë të dhunës.

Dhuna ndërpersonale: Dhuna ndërpersonale është e ndarë në dy nënkategori:

- **Familja - Dhuna familjare dhe intime** është dhuna kryesisht ndërmjet anëtarëve të familjes dhe partnerëve intimë, zakonisht, por jo ekskluzivisht, që ndodhin në shtëpi. Kjo përfshin format e dhunës si abuzimi i fëmijëve, dhuna e partnerit intim dhe abuzimi i të moshuarve. Kur dhuna ndërpersonale ndodh në familje, pasojat e saj psikologjike mund të ndikojnë prindërit, fëmijët dhe marrëdhëniet e tyre në afat të shkurtër dhe afatgjatë.
- **Dhuna në komunitet:** midis individëve që nuk janë të lidhur dhe mund ose nuk mund të njihen me njëri-tjetrin, që zhvillohet përgjithësisht jashtë shtëpisë. Ai përfshin dhunën e të rinjve, aktet e rastësishme të dhunës, përdhunimin ose sulmet seksuale nga të huajt dhe dhunën në mjediset institucionale siç janë shkollat, vendet e punës, burgjet dhe shtëpitë e pleqve.
- **Abuzimi online dhe hakmarrja pornografike** - Kjo sjellje abuzive mund të ndodhë midis partnerëve intime, miqve, kolegëve të punës, klientëve në një kompani etj.
- **Hakmarrja pornografike** - dikush me një urrejtje, si një ish-partner, poston videot nudo ose gjysmë të zhveshura ose fotot e një personi online për t'u hakmarrë. Ndonjëherë, partnerët aktualë do të kërcënojnë ta bëjnë këtë për të parandaluar një ndarje.
- **Fotot maniake** - bërja e fotografive rrënqethëse të dikuajt dhe postimi i imazheve pa leje.
- **Doxing** - dikush që mbledh dhe liron informacion personal në lidhje me një person tjetër në internet, të tilla si emri dhe vendndodhja e tyre reale, kështu që të tjerët mund t'i viktimizojnë ata në jetën reale.
- **Cyber ose e-stalking** - çdo lloj ngacmimi online, duke përfshirë akuza të rreme ose shpifje, vjedhje identiteti, kërcënime, kërkesë për seks, ose mbledhjen e informacionit privat.
- **Imitimi i keq** - paraqitja e të tjerëve në internet dhe publikimi i komenteve ose fotove, duke u përpjekur të prishin reputacionin e tyre (p.sh. duke futur fytyrën në një imazh të një yll porno ose një viktime të dhunës).
 - **Foto dhe video përdhunimi** - postimi dhe shpërndarja e videove dhe fotove të skena të dhunës (reale ose të simuluar) për të frikësuar dhe shokuar.

Keqtrajtimi i fëmijëve: keqtrajtimi i fëmijëve është abuzimi dhe neglizhimi që u ndodh fëmijëve nën moshën 18 vjeç. Ai përfshin të gjitha llojet e keqtrajtimit fizik dhe / ose emocional, abuzimit seksual, neglizhencës dhe shfrytëzimit trafikues, gjë që rezulton në dëm të vërtetë ose dëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekstin e

një marrëdhënieje e përgjegjësisë, besimit ose fuqisë. Ekspozimi ndaj dhunës me partnerin intim gjithashtu përfshihet ndonjëherë si një formë e keqtrajtimit të fëmijëve.

Dhuna e të rinjve: dhuna që ndodh midis të rinjve dhe përfshin akte që shkojnë nga ngacmimi dhe luftimi fizik, përmes sulmeve më të rënda seksuale dhe fizike deri në vrasje.

Dhuna seksuale: Dhuna seksuale është çdo veprim seksual, përpjekje për të marrë një akt seksual, komente apo përparime seksuale të padëshiruara, ose veprime të trafikimit, ose është drejtuar ndryshe kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis.

Dhuna e synuar: i referohet situatave në të cilat një kryerës i identifikuar (ose i identifikueshëm) "paraqet (ose mund të paraqesë) një kërcënim dhune ndaj një individi apo grupi të caktuar". Këto situata të dhunës në shënjestër përfshijnë dhunën në shkollë, si dhe sjellje të tjera kriminale si stalking, dhunë në familje, dhunë në vendin e punës, krime të urrejtjes të motivuara nga paragjykimet dhe veçimi i drejtuesve, të famshmëve, zyrtarëve publikë ose familjet e tyre.

Dhuna e përditshme: Kjo lloj dhune mund t'i referohet përfshirjes së formave të ndryshme të dhunës (kryesisht dhunës politike) në praktikatat e përditshme.

Dhuna në vendin e punës: Dhuna në vendin e punës është çdo veprim në të cilin një person abuzohet, kërcënohet, frikësohet ose sulmohet në punësimin e tij ose të saj. Thashethemet, sharjet, abuzimet verbale, rrengjet, argumentet, dëmtimet e pronës, vandalizmi, sabotimi, shtyrja, vjedhja, sulmet fizike, trauma psikologjike, incidentet e lidhura me zemërimin, përdhunimet, zjarrvënien dhe vrasjen janë të gjitha shembuj të dhunës në vendin e punës. Një dhunë e tillë mund të ndodhë në vendet jashtë funksionit të biznesit (konferencat, shfaqjet tregtare), në ngjarjet shoqërore që lidhen me punën, në shtëpitë e klientëve ose larg punës, por që rezultojnë nga puna (një telefonatë kërcënuese për shtëpinë tuaj nga një klient, për shembull)


4.MASAT PER MBROTJEN E SIGURTË

4.1 Masat parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve

Aktivitetet për mbrojtjen e fëmijës janë ato që lidhen si me parandalimin e abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijës edhe ato që i përgjigjen situatave të abuzimit kur ato ndodhin. E thënë ndryshe, në këtë lloj këndvështrimi mbrojtja e fëmijëve është njëkohësisht si *proaktive* dhe *reaguese*. Shpeshherë kjo lloj përqasje njihet ndryshe dhe me termin - vazhdueshmëria e përkujdesjes.

Në kontekstin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës, mbrojtja nuk ka të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, por në mënyrë specifike i referohet atyre të drejtave emergjente që cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë deri edhe jetën e tij si psh:abuzimi, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe veprime të tjera, të cilat dëmtojnë mbijetesën dhe zhvillimin e tyre. Në këtë situatë shpeshherë emergjente kanë rëndësi disa aktore të rëndësishëm ,të cilët ndikojnë në nxitjen por dhe lehtësimin e situatave të rrezikut të fëmijës,dhe janë pikërisht këto rrjet mbrojtëse.

Rrjetet Mbrojtëse përfaqësojnë Fëmijës



Përgjegjësitë dhe rolet kryesore të institucionit lidhur me mbrojtjen e fëmijës janë përmbledhur këtu. Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Identifikimin e fëmijëve në rrezik nëpërmjet informacioneve të siguruar nga vetë NJMF , marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, organizata, anëtarët e komunitetit, publiku , vetë fëmija/ët dhe media.
- ✓ Menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, SHSSH dhe aktorë të tjerë të nevojshëm, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.
- ✓ Ndërmarrjen e vlerësimit fillestar për të gjithë rastet fëmijëve të referuar në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës.
- ✓ Organizimin e vlerësimeve të thella e të plota për fëmijët e referuar.
- ✓ Organizimin e punës së drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet (përfshirë këshillimin dhe mbështetjen).

Qendra Rinore Venerini, nëpërmjet ambjenteve të saj, garanton mbështetje të specializuar nga stafi në një mjedis të sigurt, dashamirës dhe të rregullt. Qendra Rinore Venerini ka të gjitha përgjegjësitë që të pranuarit do të jenë të mbrojtur nga keqtrajtimi, diskriminimi, lënia pas

dore, etj. Kujdesi është pjesë e shërbimeve që ofrohen për të përmbushur nevojat e të pranuarve dhe mbështetjen e familjeve apo kujdestarëve të tyre. Qendra Rinore Venerini ka përzgjedhur personel të kualifikuar dhe do të zhvillojë shprehitë dhe praktikën profesionale të stafit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të tyre.

4.2 Përdorimi i imazheve të fëmijëve për qëllime që lidhen me punën

Fotot, videot apo çdo portretizim tjetër i një apo disa fëmijëve duhet të ketë lidhje vetëm me qëllimet e punës tonë si institucion.

Standardet e përgjithshme të komunikimit për mbrojtjen e fëmijëve:

- ✓ Të gjitha përmbajtjet e mediave promovojnë vlerat e respektit dhe barazisë si dhe ruajnë dinjitetin e njerëzve të përshkruar në to.
- ✓ Fëmijët portretizohen si individë me shumë tipare dhe një sërë potencialesh të ndryshme.
- ✓ Fëmijët nuk duhet të paraqiten si viktimë.
- ✓ Para krijimit të përmbajtjes së medias, të gjithë fëmijët e përfshirë duhen informuar në një mënyrë të lehtë për t'u kuptuar rreth qëllimit dhe përdorimit të materialeve mediatike.
- ✓ Privatësia e të gjithë njerëzve të përfshirë në një projekt ruhet në çdo kohë
- ✓ Përveç Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve, politika e Mbrojtjes së të Dhënave zbatohet për çdo formë të të dhënave / përmbajtjeve mediatike të krijuara gjatë punës.

Kur fotografoni ose filmoni një fëmijë për qëllime të punës, duhet të:

- ✓ siguroni që fotografitë, filmat, videot ose çdo media tjetër të paraqesë fëmijët në një mënyrë dinjitoze dhe me respekt dhe jo në një mënyrë të nënshtruar apo vulnerabël; sa i përket kësaj, fëmijët duhet të vishen në mënyrë të përshtatshme dhe të mos paraqiten në një mënyrë që mund të shihet si seksualisht provokuese;
- ✓ sigurohet që imazhet janë përfaqësime të ndershme të fakteve të situatës konkrete - fotografi reale të një situatë reale;
- ✓ mos dërgoni imazhe në mënyrë elektronike drejt shumë marrësve (përmes postës elektronike) dhe sigurohuni që etiketat e skedarëve të mos zbulojnë informacion identifikues të fëmijës

- ✓ per rastet kur femija eshte mbi 14 –vjec konsideroni te merrni lejen dhe opinionin e tij mbi kete çeshtje
- ✓ per femijet me te vegjel se 14 vjec merret leje me shkrim ne formen e nje formulari nga kujdestari ligjor

4.3 Perzgjedhja e stafit

Qendra Rinore Venerini zbaton një proces të rekrutimit të sigurt për të identifikuar dhe parandaluar njerëzit që mund të përbëjnë rrezik për abuzimin e fëmijëve. Kjo vlen veçanërisht për vendin ku mbajtësi i pozicionit do të punojë kryesisht ose ekskluzivisht me fëmijët.

- ☐ Punësimi për çdo vend pune të përkohshëm, praktikant, me orar të plotë ose vullnetar do të përfshijë një deklaratë në lidhje me angazhimin tonë për ruajtjen dhe promovimin e mirëqenies së fëmijëve.
 - ☐ Përshkrimi i Punës: Së bashku me të gjitha detyrat e tjera kryesore të pozicionit, aplikanti do të jetë posaçërisht përgjegjës për veprimin sipas Kodit të Sjelljes së qendrës .Mbajtësi i pozitës gjithashtu do të jetë përgjegjës për promovimin e mirëqenies së fëmijëve.
 - ☐ Seksionet e intervistës: Në panelin e intervistave gjithmonë do të ketë së paku dy persona, të ngarkuar me zbatimin e kriterëve dhe pyetjeve për të kontrolluar qëndrimin e një kandidati ndaj fëmijëve.
 - ☐ **Konfirmimet e kërkuara nga palët e treta:**
 1. Dëshmi e provës së identitetit
 2. Kontrolli i shëndetit
 3. Kontrolli i policisë / të dhënat penale
4. Të paktën dy letër referenca të kënaqshme me shkrim, ku është i mundur konfirmimi me telefon.
- ☐ **Induksioni i të ardhurve të rinj:**
 - Ofrimi i trajnimeve dhe informacioneve mbi politikat dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve te Shtëpisë Rozalba, mbi rregulloren e brendshme dhe mbi Kodin e Sjelljes.
 - Përkrahja e individëve në një mënyrë që është e përshtatshme për rolin.
 - Ofrimi i mundësive për një anëtar të ri të stafit ose vullnetar për të diskutuar mbi çdo çështje apo shqetësime në lidhje me rolin apo përgjegjësitë e tyre.

- Të njohë çdo shqetësim ose çështje në lidhje me aftësinë ose përshtatshmërinë e personit në fillim dhe t'i adresojë ato menjëherë.

□ **Trajnimi dhe zhvillimi:**

- Qendra Rinore Venerini do të ofrojë trajnime informuese dhe formuese për politikatat dhe procedurat e saj për të gjithë anëtarët e rinj të stafit.
- Në baza të rregullta, një herë në vit (minimumi), do të bëjë trajnime rifreskuese për të gjitha politikatat dhe procedurat.
- Në rast të ndonjë ndryshimi të politikave të saj ,qendra do të bëjë trajnime ndërgjegjësimi për të gjithë punonjësit për ndryshimet që kanë ndodhur

4.4 Kodi i sjelljes

Qendra Rinore Venerini dhe sigurisht Qendra rezidenciale Rozalba ka një rregullore të brendshme të organizmit dhe funksionimit të institucionit ,mbeshtetur tek ligji shqiptar dhe kodi i punës .Ne kete rregullore të brendshme janë të paraqitura në mënyrë të detajuar për secilin pozicion pune rolet ,përgjegjësi dhe masat disiplinore që rendojnë mbi personat të cilët nuk i përmbushin këto detyra.Mbështetja mbi një rregullore që bashkrëndon dhe udhëheq punën e secilit,është parim dhe kriter baze mbi të cilin ne kemi mbështetur punën dhe eksperiencën tonë. Në këtë rregullore janë të paraqitura në mënyrë të detajuar pikat si :Misioni,objektivat,parimet ,strategjitë ,detyrat dhe të drejtat e secilit.Secili prej individëve që kalon përmes procesit të rekrutimit njihet me parë me përmbajtjen e këtij dokumenti, dhe jep një zotim për përmbushjen e përgjegjësi të pozicionit të tij nëpërmjet një formulari me shkrim.Formulet dhe kontratat e punës firmosen nga drejtori didaktik i qendres

Kodi i Sjelljes

Unë jam dakord se ndërsa punoj për qendrën Rinore Venerini (si një punonjës ose si vullnetar)unë do të:

- Trajtoj fëmijët me respekt pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, prona, aftësia e kufizuar, lindja ose ndonjë status tjetër.
- Konsideroj dhe mbroj jetën nga momenti i konceptimit.

- Ndjek udhëzimet dhe standardet e vendosura nga qendra Rinore Venerini dhe nga Ligji Shqiptar.
- Marr pëlqimin / marrëveshjen nga prindërit/ kujdestarët ligjor për çdo angazhim të fëmijëve.
- Nuk do përdor gjuhë ose sjellje ndaj fëmijëve që është e papërshtatshme, ngacmuese, abuzuese, seksualisht provokative, ose kulturisht e papërshtatshme.
- Tregoj respekt, do të ndjek dhe përshtas aktivitetet dhe qasjet sipas moshës kronologjike.
- Nuk do të angazhoj fëmijët në asnjë formë të veprimtarisë seksuale dhe as të veproj, duke përfshirë pagesën për shërbime ose akte seksuale, ku sipas ligjit (zbatimit) të zbatueshme për fëmijën (duke përfshirë të gjitha pjesët relevante të Ligjit Shqiptar Nr.10 347 të ndryshuar) është nën moshën e pëlqimit ose aktin (et) janë një vepër penale sipas ligjeve përkatëse.
- Shmang çdo kontakt fizik me fëmijët, nëse është e mundur.
- Shmang çdo formë abuzimi të fëmijëve: fizike, seksuale, emocionale ose ndonjë formë e neglizhencës dhe do t'i kushtoj vëmendje çdo gjesti të parëndësishme ose mashtrues dhe gjuhës së trupit.
- Kurdo që të jetë e mundur, do të sigurohem që një i rritur tjetër është i pranishëm kur punoj në prani të fëmijëve; në raste specifike, do të sigurohem që ambienti të jetë i mbajtur publik (perde të hapura, derë, etj)
- Nuk do të ftoj fëmijët e pashoqëruar në shtëpi, përveç nëse ata janë në rrezik të menjëhershëm ose lëndim ose rrezik fizik, në të cilin rast unë duhet të marr lejen e mbikëqyrësit tim dhe të siguroj që një i rritur tjetër është i pranishëm sa herë që është e mundur.
- Nuk do të përdor kompjuterë, telefona celularë ose video dhe kamera digjitale në mënyrë të përshtatshme dhe kurrë nuk do të shfrytëzoj ose ngacmoj fëmijët, ose të përdor pornografi të fëmijëve përmes ndonjë medie (shih gjithashtu "përdorimin e imazheve të fëmijëve për qëllime pune"
- Përmbahem nga çdo ndëshkim fizik ose disiplinë e fëmijëve.
- Nuk do të angazhoj fëmijët për punë shtëpiake ose punë të tjera që janë të papërshtatshme për shkak të moshës ose fazës së zhvillimit, gjë që ndërhyjnë me kohën e tyre të disponueshme për aktivitetet e arsimit ose që i vendos ato në rrezik të madh të lëndim për qëllime edukimi (mbrojtja e mjedisit natyror, mbajtja e klasës së pastër, pastrimi i dhomës, etj.)

- Respektoj të gjithë legjislacionin shqiptar dhe vendor, duke përfshirë ligjet e punës në lidhje me punën e fëmijëve.
- Menjëherë të raportoj shqetësimet ose pohimet për abuzimin e fëmijëve në përputhje me procedurat e duhura. Çdo dështim për të raportuar raste të vëzhguara të abuzimit të fëmijëve konsiderohet abuzimi i fëmijëve vetë.
- Vishem në mënyrë të përshatshme me ambjentin edukativ ku punoj
- Nuk përhap historinë e fëmijës që ndoshta për të mirën e punës më është besuar
- Deklaroj që jam dakort me kodin e sjelljes që më është paraqitur nga Drejtoresha e Qendrës dhe jam i vetdijshëm që mosrespektimi i ndonjëres nga pikat e këtij kodi do të ketë pasoja që mund të çojnë deri në largimin nga puna.

Ne rastet e shkeljeve disiplinore merren keto masa:

1-Shyrtohet veprimet apo sjelljet jo te duhura

2-Jepen mendime nga eproret ose ndonjë anëtar i stafit

3-Vendimi i komunikohet Drejtorise se Shërbimeve te Brendshme,e cila pas nje afati prej pesë ditësh qe i lihet punonjësit per te drejtën e ankimit,e percjell tek Drejtori i Pergjithshem

4-Drejtori i Pergjithshëm, cakton masen disiplinore ose refuzimin e propozimit sipas rastit.Ne disa raste mund te propozohete dhe ngritja e komisioneve.

Format e masave disiplinore

- a. Verejtje me shkrim(1 vit)
- b. Verejtje me paralajmerim(1 vit)
- c. Pezullim nga e drejta per ndritjen ne detyre
- d. Largim nga puna)

Ne rastet kur propozohet largimi nga puna nuk aplikohen tre masat e tjera te mesiperme.Po ashtu edhe ne rastet kur kemi angazhim te vullnetareve ne kete qender ,aplikohet nje forme e deklarates me shkrim, e cila gjithashtu firmoset nga Drejtori Didaktik.Cdo vullnetar kontrator,vizitor apo punonjes njihet paraprakisht me kodin e sjelljes dhe rregulloren e brendshme te institucionit,e cila ka afat nje vit.

5.LINJAT E PROCEDURAVE TE MBROTJES

5.1 Linjat e përgjithshme

Ngritja e një shqetësimi në lidhje me mbrotjen është përgjegjësia e gjithsecilit. Parimi i procedimit të shpejt i të gjitha shqetësimeve duhet të jetë në kohë dhe duhet të ndermerren masa për të adresuar këto shqetësime. Qendra do të angazhohet për të informuar stafin, anëtarët drejtues, vullnetarët, bashkëpunëtorët, përfituesit, vizitorët dhe personat e kontraktuar për të siguruar shërbime për politikën e mbrotjes, rolin e oficerit të mbrotjes dhe procedurat që ndiqen për ngritjen e një shqetësimi. Do të përdoren mjete dhe mënyra të ndryshme komunikimi online dhe offline, për të transmetuar këtë informacion tek të gjithë, duke përfshirë edhe përfituesit. Kontaktet e oficerit të mbrotjes do të jepen për të sqaruar ndonjë pyetje apo pasiguri rreth procedurave të mbrotjes, për të nxitur transparencën dhe komunikimin e dyanshëm, ndokush që ngre një shqetësim do të mbahet i informuar për gjendjen dhe ecurinë e rastit derisa të zgjidhet.

5.2 Vlerësimi i rrishtit

Rastet e vlerësimi të rrishtit në Qendrën Rinore Venerini janë të zakonshme dhe bëhen në mënyrë periodike pothuajse për secilin rast ku në shohim një mundësi të tillë. Megjithatë rastet me të shpeshta, ku ka një probabilitet më të madh për të ndodhur një situatë rreziku janë zakonisht për vajzat/fëmijët dhe adoleshentët të cilët sapo kanë ardhur në qendër, por nuk përjashtohet mundësia edhe të atyre vajzave/fëmijëve/adoleshentëve të cilët tashmë janë të inseruar. Faktor kryesor rreziku për vajzat/fëmijët/adoleshentët në përgjithësi mund të jënë shumë, por një ndër më kryesoret më të cilat në jemi hasur kanë qenë lidhjet e hershme intime që ata kanë patur.

Oficeri i mbrotjes Rolet dhe Përgjegjësitë

Zyra e mbrotjes në qendrën tone drejtohet nga punonjësja sociale, e cila është përgjegjësjë kryesore për implementimin e politikës së mbrotjes. Qendra Venerini ka vendosur pozicionin e oficerit të mbrotjes për të siguruar që kjo politikë mbrotjeje është duke u zbatuar dhe përpjekjet për mbrotjen janë efektive. Ky pozicion ekziston për të përforcuar kapacitetet e mbrotjes së qendrës Venerini, sistemet dhe proceset që mundësojnë sigurinë e fëmijëve dhe adoleshentëve, punonjësve, kontraktuesve, vullnetarëve etj.

Përgjegjësitë e oficerit të mbrotjes

- Sigurohet që gjithë stafi është në dijeni se si ngrihet një shqetësim mbrotjeje

- Sigurohet që të gjithë vullnetarët, stafi, vizitorët apo njerëzit e tjerë me të cilët bashkëpunojnë janë në dijeni të kësaj politike
- Mban relacione të sakta dhe të sigurta për mbrojtjen
- Është vigjilent për të njohur ceshtjet e mireqënies
- Ndan informacione të përshtatshme me njerëzit e duhur
- Sigurohet që gjithë stafi që ka kontakte me fëmijet ka marrë trajnimin e përshtatshëm mbi ceshtjen e mbrojtjes. Mban shënim pjesëmarrjen në trajnime
- Sigurohet që politika e mbrojtjes aplikohet në vlerësimin dhe përzgjedhjen e njerëzve dhe shërbimeve
- Merr masa për shqetësimet e raportuara
- Rregjistron shqetësimet e ngritura dhe mban palët e informuara
- Mbledh informacione dhe prova të nevojshme
- Kontakton me shërbimin social apo institucione të tjera shtetërore
- Sigurohet që politika është implementuar dhe e promovon atë
- Vepron si pikë e parë kontakti për qendrën Venerini lidhur me mbrojtjen e fëmijëve
- Monitoron rregullisht masat e mbrojtjes
- Sigurohet që të gjitha mesimet nga zbatimi i politikës reflektohen (nese është nevojshme bëhen korigjime të politikës) dhe zbatohen.

Oficer i mbrojtjes

Informacion kontakti: Fondacioni “Venerini”

Emri: Albina Ndreu

Adresa: Lagjia Besëlidhja, Lezhë


Cel: 00355673930586

Email: albinandreu@hotmail.com

Hapat që ndiqen për vlerësimin e riskut janë:

- Njohja: Komunikim i drejtpërdrejt me fëmijën nga persona ku tashmë është formuar një lidhje besimi për të shprehur me Punonjesin social ose psikologun e qendrës
- Përgjigje, Diskutim: Bashkëpunim mes antareve të stafit si punonjes social psikolog dhe në disa raste kujdestaret, me qëllim evidentimin e një problemi dhe bashkëpunimin e informacionit
- Plotësimi i formularëve nëse ka të bëjë me rast abuzimi

- Referim i problemti tek eproret ose drejtori didaktik.
- Bashkepunim sipas rastit me insitucione loka le si NJMF ,SHSSHapo te tilla si prsh shkolla ku femija kalon nje pjese te mire te dites .
- Monitorim i vazhdueshem i situates



5.6 Menaxhimi i rastit

Ekzistojne katër forma rrezikut ,te cilat mund te jene te brendshem ose te jashtme ,me te cilat perballen ose jane përballur vajzat e qendres” Rozalba”:

1. Rreziku që vjen nga familja biologjike ,nje i afërm, nga person me te cilin vajza ka nje raport intim, ose nga përsona të tjerë të jashtëm
2. Rreziku i fëmijëve/adoloshentit nga punonjësit
3. Rreziku i punonjësve nga fëmija/adoloshenti
4. Rreziku i fëmijëve/adoloshentëve nga njëri –tjetri

Per te gjitha rastet e mësipërme mbahen shënime te detajuara me shkrim ne struktura te tilla si skeda observimit,dhe behen relacione nga punonjesi social qe me pas sipas rasteve frmosen nga stafi ose drejtori didaktik.

- 1- Kur indetifikojme nje nga fëmijët/adoloshentët qe ka nje raport familjar ose intim i cili mund te cenoje ate ne menyre te drejteperdrejte(rrezik i jashtem).

- Kërkojmë këshilla nga shërbimet e duhura profesionale
- Përpiqemi të ruajme qetësinë dhe dëgjojmë me kujdes atë që thuhet duke i dhënë mundesi që personi të flasë me ritmin e tij , duke u kujdesur që të mos komprometojë dëshmi të mundshme

- Nëse besojmë që personi është 'në rrezik' të dëmit të menjëhershëm, i cili përfshin situata të cilat çdo punonjës ose vullnetar do të besonin në mënyrë të arsyeshme, kërkohet shërbime emergjente, atëherë kontaktojmë shërbimin përkatës të urgjencës dhe njoftohet Oficeri Mbrojtës dhe Menaxhuesin e Linjës ose drejtorin didaktik te qendres
- Perpiqemi te bejme vetëm pyetje për sqarime dhe jo pyetje udhëheqëse që sugjerojnë përgjigje të caktuara, pasi e kemi te qarte se kjo mund të kompromentojë provat
- Sigurojmë fëmijën vulnerabël që ata kanë bërë gjënë e duhur me ardhjen përpara për atë që ka ndodhur
- Ju tregojmë atyre se çfarë do të bëni më pas dhe kë do të informoni
- Menjëherë njoftojmë Menaxherin e Linjës, Oficerin Mbrojtës ose Drejtorin Didaktik
- Sa më shpejt që të jetë e mundur bejme rregjistrimin e të gjitha detajeve që jemi të vetëdijshëm për Formularin e Raportimit për Garantim Mbrojtjeje për dyshim të abuzimit
- Nëse është marrë vendimi për të bërë një referim tek autoritetet lokale, ajo regjistrohet në formular.

2-Rreziku i fëmijëve/adoloshentëve nga punonjësit ne eksperiencën tonë ka qene me pak i prekshem. Ne rastet e tilla ne kemi procedura te gatshem për mënyrën se si te trajtojmë një problem te tillë

- Marrim seriozisht deklaratën ose shqetësimin e cila mund te vije nga vete femija apo nje punonjes ,apo person tjeter;
- Informojmë menjëherë Oficerin Mbikëqyrës, Menaxherin e Linjës ose Menaxherët e tjerë, ose Drejtorin Didaktik(sipas rastit);
- Oficeri Mbrojtës të informojë Drejtorin Didaktik te Qendres Venerini sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe të sigurojë një raport të incidentit dhe veprimin e synuar në përputhje me procedurën zyrtare të punësimit të qendres Venerini
- Pezullojmë ne mënyre te menjëhershme nga të gjitha punët ose angazhimi me Qendren Rinore Venerini personin e dyshuar për keqpërdorim, i cili do të dërgohet në një leje të plotë me pagesë deri në përfundimin e hetimit dhe heqjes nga shqetësimi;
- Regjistrojmë të gjitha detajet që ju jeni të vetëdijshëm për Formularin e Raportimit të Sigurisë për Dyshimet e Abuzimit sa më shpejt që të jetë e mundur;

- Sigurojme që Oficeri i Mbrojtës të konsultohet me Qendren Rinore Venerini , eproret dhe pjestarët e tjere te stafit nese është e nevojshme ose të bëjë një referim formal tek autoritetet lokale;
- Sigurohemi që Zytari Mbrojtës të kontaktojë Autoritetet Lokale.

Çdo anëtar i Bordit, punonjës ose vullnetar mund të bëjë një referim tek autoritetet lokale nëse ata besojnë se një rast është hetuar në mënyrë të papërshtatshme ose jo efektive nga Zytari Mbrojtës ose nga Qendra Rinore Venerini

3-Rreziku i punonjësve nga fëmijët/adoloshentët është me i prekshem dhe me real,duke patur parasysh se sidomos vajzat ne qender janë te ngarkuara ne aspektin psiko-social,dhe situatat e jetuara me perpara ne familjet e tyre apo edhe institucionet ku kane qene me perpara,i nxisin drejt ne sjellje jo korrekte.

Hapat që merren ne raste te tilla janë:

- Merret i gjithë informacioni i nevojshem nga te dy palet në prani te psikologut ose punonjësit social me qellim identifikimin e problemit
- Informohet meneaxheri i linjes dhe oficeri i mbrojtës ,sipas rastit mund te infomohen edhe eproret ose drejtori didaktik
- Degjohen me kujdes te dy palet dhe personat, qe mund te kene qene prezent nese ka ndodhur nje konflikt verbal ose fizik.
- Te gjitha te dhenat regjistrohen ne skeden e observimit dhe behet nje relacion i paosacem qe me pas i dergohet sherbimit social dhe NJMF
- Shikohet dhe mundesia e zgjidhjes se konfliktit brenda insitucionit,perndryshe njoftohen autoritet lokale
- Ne rastin e zgjidhejs se konfliktit brenda qendres, monitorohet me kujdes veprimet e pasme ne menyre që suate te tilla te shmangen ose personat te kene pak kontakt per nje periudhe kohe te caktuar

4-Rreziku i fëmijëve adoloshentëve nga njeri-tjetri është me i zakonshmi në Qendren Venerini.Ka raste te konfliktit me natyre verbale por ndonjëhere edhe fizike,duke qene se fëmijet janë ne një moshe delikate.

Hapat që ndiqen ne këto raste janë:

- Identifikimi dhe njohja e problemit,te dy palet ftohen te sqarojne situatën
- Kujdestari apo edukatori që mund te kete qene pergjegjes ne atë orar për kujdesin ndaj femijës raportojne mbi situaten.

- Sipas rastit ose natyrës se konfliktit informohet menaxherët e rastit dhe oficeri i mbrojtës të cilët marrin në shqyrtim situatën
- Nëse është një konflikt verbal synohet që zgjidhja të propozohet dhe të vijë nga vete protagonistët e konfliktit
- Kur kemi të bëjë me konflikt fizik, plotësohet formulari i abuzimit dhe regjistrohet të dhënat, njoftohen edhe institucionet lokale
- Monitorohet dhe ndiqet procesi i zgjidhjes së konfliktit nga oficeri i mbrojtës dhe një përfaqësues i autoriteteve lokal



5.7 Monitorimi dhe vlerësimi

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të politikave realizohet nga punonjësi social i qendrës, i cili organizon në mënyrë periodike takime me stafin, vullnetarët, takime individuale ose në grup me vajzat e qendrës. Nëpërmjet këtyre takimeve punonjësi social verifikon punën e bërë deri në atë pikë duke patur parasysh objektivat e vendosura dhe qëllimet e secilit pozicion. Nëpërmjet këtij procesi synohet të

evidentohen pikat e forta dhe ato te dobëta ,vështirësite e implementimit te politikës dhe jepen udhëzime per punën e mëtejshme, me qëllim perbushjen e synimeve dhe realizimin e objektivave te politikës.Po ashtu i njejti përgjegjes per politikat qe ne,nëpermejt takimeve me vajzat qofte ne grup qofte individuale, perpiqet qe te kuptoje se sa te prekshme dhe te arritshme jane bere keto politika dhe deri në çfare mase eshte bere impletimi i tyre tek vajzat në menyre te drejtperdrejte.

Procesin e monitorimit te politikave behet nga keta pesona:

1. Pergjegjsi per politikat
2. Menaxheri i rasteve
3. Kujdesaret
4. Drejtori didaktik

Indikatoret per vleresimin e politikave :

1. Pyetsoret
2. Takimet individuale dhe takimet në grup
3. Përqindja e menaxhmit te rasteve me sukses
4. Përqindja e parandalimit te rrezikut
5. Përqindja e raportimit te rasteve te reja
6. Përqindja e evidentimit e rasteve te reja

5.8 Porçedurat e ankimit

Per proçedurat e ankimit dhe menyren se si ato duhet te veprojne ne raste pakneqasive,vajzat e qendres,punonjsi,vizitoret (prinderit per shebmull) jane te informuar dhe i aplikojne ne rast nevojje.Ka nje kuti ankesash e cila eshte vendosur ne një vend te dukshem ne dhomen e e ndjenjes aty ku priten dhe vizitoret dhe ku vajzat kalojne pjesen me te madhe te kohes.Ne kutine e ankesave hidhen te gjitha anksat me shkrim qe vajzat kane,po ashtu janë informuar edhe personat e tjera per kete mundësi.Kutia ankesave hapet vetem nga punjonjesi social i SHSSH, i cili e viziton Qendren njehere ne muaj dhe ben edhe takime me vajzat per te kuptuar me mire shqetësimet e tyre.Po ashtu ankesat mund te drejtohen tek punonjësi social i qendres,tek kujdestaret ose çdo person tjetër i besuar, qofte i stafit apo vullnetar i cili me pas raporton dhe organizon punën per ngritjen një shqetësimi te caktuar .

ANEKS 1

6. PROÇEDURAT QË NDJEK SHTËPI FAMILJE “ROZALBA”.

6.1 Proçedurat për kujdesin shëndetësor

Për të gjithë të pranuarit në Shtëpia Rozalba plotësohet një skedë e posaçme për gjendjen dhe nevojat shëndetësore. Informacioni mbi patologjinë e klientit është konfidencial dhe mbahet në një dosje të veçantë dhe përdoret vetëm nga personat e autorizuar si: Stafi përkuqjesës apo infermieri. Në dosje përfshihet edhe një autorizim që lëshon prindi për mjekimin që do ti bëhet të pranuarit. Të pranuarit e vendosur në Shtëpia Rozalba marrin përkuqjesjen shëndetësore parësore te mjeku i përgjithshëm i lagjes ku ndodhet Shtëpia Rozalba. Gjithashtu kryejnë vizita mjekësore periodike tek pediatri, okulisti, dentisti apo neurologu.

Shtëpia Rozalba bashkëpunon me prindërit që të plotësojnë nevojat e të pranuarve për kujdesin shëndetësor.

Shtëpia Rozalba inkurajon të pranuarit që të kujdesen dhe të ruajnë gjendjen e tyre shëndetësore nëpërmjet shërbimeve vetjake, higjienës personale, kujdesit për dhëmbët, marrjes së dietës së nevojshme, etj. Në ambientet e brendshme dhe në ambientet e jashtme të qendrës ndalohet pirja e duhanit, për të mbrojtur shëndetin e klientëve dhe të punonjësve.

6.2 Proçedurat për arsimimin

Të gjithë të pranuarit në Shtëpia Rozalba ndjekin programet mësimore në bazë të moshës së tyre.

Plani i arsimimit është pjesë e planit të kujdesit dhe përfshin të gjithë të dhënat që lidhen me historinë e progresit të dijeve të tij, nivelin e të nxënës shkollimin që mund të ketë marrë deri në këtë moment i pranuari, etj.

Shtëpia Rozalba , në bazë të vlerësimit të të pranuarve lidhur me nivelin e zhvillimit dhe grup-moshën, organizon plotësimin e kërkesave për arsimimin e tij brenda në qendrës.

Drejtuesit e qendrës ndjekin dhe vlerësojnë progresin e programeve nga të pranuarit, dhe marrin masa për rishikimin dhe plotësimin e tyre.

6.3 Proçedurat për zbavitjen

Të pranuarit marrin pjesë në veprimtari të ndryshme që të mundësojnë zhvillimin e tyre por edhe të argëtohen. Veprimtaritë që organizohen janë gjithpërfshirëse, jo vetëm brenda në qendër por edhe në aktivitete jashtë saj, me pjesëmarrje edhe nga komuniteti.

Në proçesin e programimit të veprimtarive merren parasysh dhe mendimet, dëshirat dhe ndjenjat e të pranuarve, i personelit dhe i familjarëve.

6.4 Konsultimi me të pranuarit

Vlerat dhe filozofia e Shtëpia Rozalba kërkojnë që të pranuarit të jenë të informuar për të gjitha çështjet që lidhen me akomodimin dhe shërbimet që do të ofrohen. Stafi i ndihmon të pranuarit, familjarët dhe prindërit të marrin pjesë në vlerësimin e gjendjes social-shëndetësore të klientëve, me qëllim që shërbimet të garantojnë mbështetjen dhe progresin e dëshiruar. Për këtë organizohen mbledhje të rregullta me të pranuarit, ndërsa personeli mban lidhje të rregullta me prindërit dhe familjarë të tjerë.

6.5 Disiplina dhe rregullat

Kontrolli dhe disiplina në Shtëpia Rozalba mbështetet në forcimin pozitiv të sjelljes nëpërmjet zhvillimit të bisedave me të pranuarit, duke i trajtuar ato me dinjitet në kohën e duhur. Njohja e gjendjes dhe e sjelljeve të pranuarve, krijon mundësi për të ndërtuar programe individuale të kujdesit që lidhen me përmirësimin e sjelljes. Për këtë rekomandohet të shfrytëzohet dhe koha e lirë duke angazhuar një punonjës, i cili ndërhyr me kujdes për të kapërcyer situatat e vështira dhe për të përmirësuar gjendjet jo komode. Shtëpia Rozalba angazhohet për ofrimin e një mjedisi të sigurt dhe pa rreziqe. Në rastet e mungesave, do të ndjekë proçedurat e drejtorisë dhe do të informojë menjëherë policinë. Në këto raste kontaktohet familja dhe informohet njësia e zjarrfikësve apo ekipi i urgjencës. Të pranuarit mbështeten që të praktikojnë zakonet e tyre fetare pa dallime, duke iu ofruar një klimë tolerance dhe respekti për gjithsecilin. Fëmijët ndjekin ritet dhe shërbesat fetare. Shtëpia Rozalba i respekton kërkesat për ofrimin e një kushteve të favorshme.

Rregullat e Shtëpisë “Rozalba”

Në shtëpinë” Rozalba” jetohet si ne familje te madhe, ku secili ka të drejta dhe detyra. Brenda kësaj shtëpie është edhe stafi drejtues që përbëhet nga: drejtoresha, psikologu, punonjësi social, edukator vullnetare.

Te jetosh së bashku do të thotë të respektojmë njëri-tjetrin!

1. Të dëgjojmë dhe respektojmë mendimin e tjetrit, duke e pranuar si një pasuri për secilin.
2. Të kemi respekt për historinë e tjetrit dhe nëse ajo na besohet miqësisht të mos e përdorim dhe të mos e përhapim.
3. Të themi gjithmonë të vërtetën edhe nëse na kushton, për situatat, ngjarjet që jetojmë
4. Në raste keqkuptimesh të kërkojmë t’i sqarojmë gjërat me qetësi.
5. Të bashkëveprojmë me stafin në mënyrë që të kemi një rritje të qetë, të sigurt dhe të plotë.
6. Të respektojmë gjërat personale, gjërat përbashkëta, t’i përdorim me kujdes gjërat që na shërbejnë.
7. Të respektojmë oraret për: studim, internet, zgjim, televizor, lojërat dhe telefonatat me të afërmit.
8. Të respektojmë dhe të kujdesemi për ambientin si: salla e ndenjes, mensa, dhomat personale (shtretërit, raftet, banjot).
9. Të kemi një vëmendje të veçantë për higjienën personale.
10. Të respektojmë kohën e pushimit e cila është e shoqëruar me heshtje.

6.6 Mbrojtja nga zjarri dhe procedurat e emergjencës

Qendra Rinore Venerini inspektohet rregullisht nga njësia e shërbimit të zjarrfikësve. Godina e strukturave përmbushë standardet e rregullores kundra zjarrit. Personeli këshillohet vazhdimisht nga punonjësit për parandalimin e zjarrit për procedurat e mbrojtjes nga zjarri. Në të gjithë ambientet e godinës vendosen fikset e zjarrit, të cilat provohen rregullisht dhe mirëmbahen. Godina pajiset me një sistem të spërkatjes me ujë.

6.7 Procedurat për realizimin e lidhjeve me familjarët

Shtëpia Rozalba inkurajon ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të pranuarve me familjarët dhe të afërmit. Pavarësisht vështirësive që has. Shtëpia Rozalba ndërton një plan të veçantë për lidhjet me familjarët dhe të afërmit, dhe kujdeset që ata të vizitojnë njësinë sa herë që kjo është e nevojshme. Shtëpia Rozalba bën përgatitjet për vizitat në shtëpi duke siguruar transportin e nevojshëm me mbështetjen e personelit. Prindërit e të pranuarve informohen

rregullisht për ecurinë e fëmijës së tyre. Punonjësit përgjegjës kujdesen për krijimin e marrëdhënieve pozitive me anëtarët e familjes, dhe për informimin periodik të tyre. Shtëpia Rozalba inkurajon dhe bën të mundur kontaktin me telefon minimalisht dy herë në javë, me anëtarët e familjes ose miqve të tyre.

6.8 Procedurat ndërinstitutionale

- **Procedurat për trajtimin e ankesave**

Të pranuarit gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Shtëpia Rozalba ndihmohen për të njohur dhe ndjekur procedurat e ankesave që ka përcaktuar drejtoria. Përfituesve dhe kujdestarëve të tyre u jepet kopje të fletushkës me informacion. Njësia afishon informacion në lidhje me organizata dhe individët, të cilët në mënyrë të pavarur mund t'i ndihmojnë dhe të rinjtë lidhur me ankesat që ata mund të kenë. Shtëpia Rozalba informon të pranuarit për shërbimin e Avokatisë që ofrohet nga një organ i pavarur bamirës. Ankesat në lidhje me standardet e kujdesit në Shtëpia Rozalba, mund t'i drejtohen edhe institucioneve shtetërore që kontrollojnë në mënyrë periodike punën e stafit apo dhe gjendjen e vajzave, si NJMF Bashkia Lezhë apo Shërbimi Social Shtetëror.


- **Procedurat për trajtimin e mbledhjeve të rishikimit**

Mbledhjet e rishikimit bëhen në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara nga drejtoria. Për të pranuarit e vendosur në Shtëpia Rozalba caktohet një inspektor i Zyrës Rajonale të SHSSH. Kujdestari / punonjësi social i Shtëpia Rozalba merr pjesë në mbledhjen e rishikimit, dhe harton një relacion me shkrim në emër të njësisë i cili i bashkëlidhet dokumentit të rishikuar. Në çdo rishikim gjithmonë do të ketë një përfaqësues të qendrës. Punonjësi kyç do të ndihmojë të pranuarin që të marrë pjesë në rishikimin e Planit të Kujdesit të rishikuar. Qendra cakton një dhomë të përshtatshme për mbledhjen e rishikimit kur këto realizohen në institucion, ka edhe raste kur këto mbledhje realizohen në zyrat shtetërore përkatëse me përfaqësues punonjësin social të qendrës.

- **Procedurat për periudhën kalimtare dhe largimin nga Qendra**

Qendra Rinore Venerini ndihmon të pranuarin që të arrijë një shkallë sa më të lartë pavarësie që të jetë e mundur deri në kohën që largohet nga struktura e kujdesit. Në kohën e largimit nga Shtëpi-Familja, hartohet një program i detajuar në përputhje me nevojat e individit të cilat të mund të përmbushen gjatë fazës së ardhshme të jetës së tij në familje.

VAZHDUESHMERIA E PERKUJDESIT



6.9 Fomular

Kontratë Vullnetariati

Unë e nëshkruara _____ lindur
me _____ lidh kontratë vullnetariati në rolin e edukatorës me
Qendren Rinore Venerini. Shërbimi im në këtë qender do të zgjas 1 vit. Kontrata mund të
zgjidhet nga Drejtori i Qendres në çdo rast që Vullnetari të mos zbatoj rregullat e kësaj
qendre, të mos përqafoj vlerat dhe të mos ndihmojë në arritjen e objektivave që janë vënë për
secilen vajzë!

Vullnetari

Drejtoresha Didaktike

Arta Suli

Deklaratë me shkrim

Unë e kuptoj se është përgjegjësia ime të përdor sensin e përbashkët dhe të shmang veprimet
ose sjelljet që mund të interpretohen si abuzim i fëmijëve duke punuar si punonjës ose
vullnetar në çdo vendosje të organizuar nga Qendra Rinore venerini me organizatat e tij
partnere, si dhe do të ndjek të gjitha udhëzimet nga “Politika dhe Procedurat Mbrojtëse” dhe
“Kodi i Sjelljes” të qendres rinore venerini

.....
Emri i plotë (Ju lutem me gërma kapitale)

..... Firma

.....Data

SKEDA OBSERVIMI

*MUAJI*_____

*QENDRA RINORE
VENERINI*

EMRI VAJZES	DATA	OBSERVIMI	FIRMA E EDUKATORIT
-------------	------	-----------	-----------------------

--	--	--	--

Formular Tip për Raportimin e Dyshimeve për Abuzim

Pjesa e Parë: Rreth Teje

Emri:

.....
.....

Roli juaj në Qendren Rinore Venerini:

.....
.....

Detaje të një organizate tjetër të përfshirë:

.....
.....

Marrëdhënia juaj me fëmijën apo të rinjtë e prekur:

.....
.....

Pjesa e Dytë: Rreth Fëmijës/Të riut (rinjve)/ vulnerabël

Emri(at):

.....
.....

Gjinia:

.....
.....

Mosha:

.....
.....

Adresa:

.....
.....

Me kë jeton fëmija apo i riu/e reja?

.....
.....

Pjesa e Tretë: Rreth shqetësimit tuaj

Si lindi shqetësimi juaj: a u konstatua apo dyshohej?

.....
.....

A u ngrit nj akuzë? A është zbuluar ndonjë abuzim ndaj fëmijëve?

.....
.....

Data, koha dhe vendi i incidentit(eve):

.....
.....

Natyra e shqetësimit/akuzës:

.....
.....

Vrojtimet e bëra nga ju (p.sh., gjendja emocionale e fëmijës, çdo dëshmi fizike):

.....
.....

Shkruani ekzaktësisht atë cfarë tha fëmija dhe cfarë thatë ju:

.....
.....

.....

Ndonjë informacion tjetër përkatës? (p.sh. paaftës, gjuha)

.....
.....

.....

A ishin fëmijë të tjerë të përfshirë apo në dijen A e keni raportuar këtë tek prindërit apo kujdestarët apo ndonjë anëtar stafi apo agjenci për mbrojtjen e fëmijëve?

.....
.....

.....

Koha dhe data e raportimit:

.....
.....

.....

Personi(at) ndaj të cilit ishte bërë raportimi:

.....
.....

.....

Këshilla e dhënë:

.....
.....

.....

Veprimi i ndërmarrë:

.....
.....

.....
.....

.....

Pjesa e Katërt: Nënshkrimet

Raportuar Firma.....
nga: Data:

Raportuar nga:

..... Firma..... Data:
.....

PERDORIMI I IMAZHEVE TE FËMIJEVE PER QËLLIME PUNE:

Unë nuk do te filmoj ose te bëj foto te të miturve pa leje:

- ✓ Do sigurohem që fotografitë, filmat, videot ose çdo media tjetër të paraqesë fëmijët në një mënyrë dinjitoze dhe me respekt dhe jo në një mënyrë të nënshtuar apo vulnerabël; sa i përket kësaj, fëmijët duhet të vishen në mënyrë të përshtatshme dhe të mos paraqiten në një mënyrë që mund të shihet si seksualisht provokuese;
- ✓ Do të sigurohem që imazhet janë përfaqësime të ndershme të fakteve të situatës konkrete - fotografi reale të një situatë reale;
- ✓ Nuk do dërgoj imazhe në mënyrë elektronike drejt shumë marrësve (përmes postës elektronike) dhe sigurohuni që etiketat e skedarëve të mos zbulojnë informacion identifikues të fëmijës
- ✓ Per rastet kur femija eshte mbi 14 –vjec konsideroni do te sigurohem të marr leje dhe opinionin e tij mbi kete çeshtje

- ✓ Per femijet me te vegjel se 14 vjec do sigurohem te marr leje me shkrim ne formen e nje formulari nga kujdestari ligjor

Unë e kuptoj që është përgjegjësia ime që te perdor sensin e përbashkët dhe te shmang veprimet apo sjelljet që mund te perceptohen si abuzim me fëmijët ,ndersa punoj si vullnetar apo i paguar i qendres “Venerini”.

Emri.....Firma.....

Leje nga kujdestari ligjor

Unë i nënshkruarijam dakord dhe jap lejen time për fotografimin ,filmimin dhe regjistrimin enë emer te qendre venerini.Unë autorizoj dhe jap leje për përdorimin ,ruajtjen dhe riprodhimin e imazhve per qëllime publikimi per aktivitete ,programet e qendres” Venerini”

Emri fëmijes.....Emri kujdestarit.....Firma\Data.....

Leje nga fëmijet mbi 14 –vjec

Unë i nënshkruari.....jam dakord dhe jap lejen time per fotografim,filmim,apo forma te tjera te regjistrimit elektronik per mua ne emer te qendres “Venerini”.Autorizoj dhe jap lejen per koleksionimin,ruajtjen dhe perdorimin e imazheve per qëllime te publikimit te aktiviteteve dhe sherbimebimeve te qendres “Venerini”

Emri/Firma/Data.....

LISTA E REFERENCAVE

Për qëllim të hartimit të kësaj politike, u aksesuan material online si më poshtë:

- a) Konventa për të drejtat e Fëmijëve
- b) Protokolli për të drejtat e fëmijëve
- c) Legjislacioni Shqiptar
- d) Mery Ėord Loretto

e) Rregullorja e Brendshme e Qendres Venerini

f) Kodi sjellje